

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje karburanti për automjetet, gazoil dhe benzinë – Marrëveshje Kuadër – Me një operator ekonomik fitues ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – Me afat të Marrëveshjes Kuadër 12 muaj.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 09132000-3; 09134000-7.

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi total i Marrëveshjes Kuadër – 3,758,790 (tre milion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind nëntëdhjetë) lekë pa T.V.SH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Çerdheve dhe Kopshteve ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

(Të plotësohet çdo nënseksion i Deklaratës për përmbushjen e kritereve të përgjithshme të kualifikimit, Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit, si dhe çdo seksion tjetër sipas udhëzimeve të APP)

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi për furnizimet e meparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një

vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit.

- Operatori ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Operatori Ekonomik për të vertetuar përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar nenit 55 pika 4 gërma b e VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” është përcaktuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2 OE duhet të disponojë Licencë për stacion shitje karburantesh, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajra lubrifikantë lëshuar nga Bashkia e Tiranës.

Dhe/ose

Licencë për ushtrimin e aktivitetit (tregëtim karburantesh) të lëshuar nga QKB:

Kategoria: “Prodhimi, depozitimi, transporti, përdorimi dhe/ose tregtimi i produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri”.

Nën kategoria: “Tregëtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse”.

Kodi: VIII.1.A

Argumentim: Kërkesa që OE të disponojë licencë Kategoria: “Prodhimi, depozitimi, transporti, përdorimi dhe/ose tregtimi i produkteve dhe/ose lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri”, Nën kategoria: “Tregëtimi me shumicë i naftës, gazit, nënprodukteve përfshirë ato bio si dhe lëndët djegëse” (VIII.1.A) është vendosur referuar Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 15.

2.3.3 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Fletë-Analizë për produktet e kërkuara:

- Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD), S SH EN 590:2025 ose ekuivalente.
- Benzinë pa plumb (Premium UNL 10ppm), S SH EN 228:2025 ose ekuivalente,

lëshuar nga organi kompetent, ose nga një laborator shqiptar i çertifikuar, ose i huaj (*n.q.s është laborator i huaj, duhet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar*), që vërteton cilësinë e produktit objekt i këtij prokurimi, sipas standardeve të përcaktuara në pajtueshmëri me specifikimet teknike, e lëshuar jo më parë se muaji Janar 2026.

Argumentim: Kriteri për paraqitje Fletë-Analizë për produktet e kërkuara është vendosur me qëllim konfirmimin e standarteve të përcaktuara në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nën produkteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzene dhe diesel”.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitet 2024, 2025 dhe 2026.

Argumentim: Kriteri që OE duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga ISHTI, që subjekti nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësisë për vitet 2024, 2025 dhe 2026 është vendosur për të siguruar Autoritetin Kontraktor që Operatori Ekonomik për periudhën e kërkuar ka ushtruar aktivitetin konform ligjeve dhe rregullave që ato përcaktojnë për tregtimin e karburanteve, në zbatim të Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzene dhe diesel”.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatën ISO 9001:2015, ose ekuivalente lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë të vlefshme, të cilat të përfshijnë objektin e prokurimit.

Argumentim: Kriteri që OE ofertues duhet te paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 ekuivalente të saj, të vlefshme, per tregtimin e produkteve, konsiston në kërkesën që ai duhet të zotërojë “Sistemin e menaxhimit të cilësisë” së produkteve që ai tregëton.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me çertifikatën ISO 14001:2015 për sistemin e menaxhimit të mjedisit, ose ekuivalente, të vlefshme, të cilat të përfshijnë objektin e prokurimit.

Argumentim: Kriteri që OE ofertues duhet te paraqesë Çertifikatën ISO 14001:2015 për sistemin e menaxhimit të mjedisit ose ekuivalent me të, konsiston në kërkesën që ai duhet të zotërojë “Sistemin e menaxhimit të mjedisit” për produktet që ai tregëton, kjo është e lidhur ngushtë me vetë natyrën e produkteve objekt prokurimi.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me:

- Vërtetim Teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga organe të miratuara të vlerësimit të konformitetit.
- Akt Teknik të lëshuar nga PMNZH.
- Policë Sigurimi për përgjegjësinë e palëve të treta.

Argumentim: Kërkesa e vendosur për pajisjen e OE me vërtetim teknik të lëshuar nga ISHTI ose nga organe të miratuara të vlerësimit të konformitetit është vendosur në zbatim të Urdhërit nr 315, date 24.08.2017 “Për procedurat e lëshimit të vërtetimit teknik për subjektet që kryejnë aktivitetet në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregëtimit të naftës dhe nënprodukteve të saj”.

Kërkesa e pajisjes se OE me akt teknik të lëshuar nga PMNZH, është vendosur në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 datë 21.12.2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Kërkesa për pajisjen e OE me police sigurimi për përgjegjësinë e palëve të treta është vendosur në zbatim të VKM Nr.1047, datë 16.7.2008, pika 7, ku përcaktohet “Shoqëritë e pajisura me leje tregtimi ose autorizim, brenda 30 ditëve nga data e pajisjes, duhet të kryejnë sigurimin e përgjegjësisë ligjore për dëmet, qëmund t’u shkaktohen palëve të treta, për shkak të ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë”.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet te paraqes nje vetdeklarim ku te deklaroje merr përsipër furnizimin e pandërprerë me karburant në të paktën 2 (dy) pika karburanti brenda qytetit të Tiranës në pronësi ose me qera, të cilat do të shërbejnë për furnizimin e automjeteve të AK. Në deklaratë duhet të përcaktohet qartë vendndodhja e pikave të karburantit.

Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit** duhet të paraqesë:

Certifikatën e pronësisë dhe/ose kontratën e qerasë dhe/ose marrëveshjen e bashkëpunimit për pikat e karburantit.

Argumentim: Vendosija e kriteri që OE duhet të deklarojë me shkrim se garanton dhe merr për sipër furnizimin e pandërprerë me karburant në të paktën 2 (dy) pika karburanti brenda qytetit të Tiranës, nga ana e AK është bërë duke patur parasysh numrin e automjeteve të cilat duhet të furnizohen me karburant gjatë zbatimit të kontratës si dhe destinacionet periodike ditore që ato kryejnë në funksion të zbatimit të detyrave funksionale që ato kanë.

AK disponon 8 automjete të tipit “Furgon frigoriferikë” të cilët shërbejnë për shpërndarjen e produkteve ushqimorë dhe mallrave të inventarit nëpër çerdhet dhe kopshtet e qytetit të Tiranës. Intenerari i tyre është i përcaktuar për çdo ditë. Ato e kryejnë aktivitetin e tyre vetëm brenda qytetit të Tiranës, kështu që është e domosdoshme dhe e mjaftueshme që ato të kenë mundësi të furnizohen me karburant në të paktën 2 pika karburanti brenda qytetit të Tiranës. Kjo për arsye se, në çdo rast që pikat e karburantit të OE do të ishin jashtë qytetit të Tiranës, do të sillte kosto të shtuara të shpenzimeve për karburant të nevojshëm vetëm për kryerjen e vet procesit të furnizimit të automjeteve

Gjithashtu, edhe dy automjetet e tjera të tipit autoveturë, e kryejnë aktivitetin e vetë vetëm brenda qytetit të Tiranës në funksion të detyrave funksionale të Administratës së DPÇK .

Argumentim i përgjithshëm: Për përcaktimin e kriterëve teknike të kualifikimit, janë patur parasysh specifikat e produkteve “Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD)” dhe “Benzinë pa plumb (Premium UNL 10ppm)”, kërkesat që përcakton Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzine dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, i ndryshuar, VKM nr 344, datë 19.04.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin në VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” për tregëtimin e këtyre produkteve të saj”.

II. Argumentim për hartimin e specifikimeve teknike:

Hartimi i specifikimeve teknike të Gazoil (Diesel 10 ppm ULSD) dhe Benzinë pa plumb (Premium UNL 10ppm) është bërë në përputhje me Standardet Shtetërore në fuqi të publikuara aktualisht në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Standardeve, Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për

përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, VKM nr. 147, datë 21.03.2007 “Për cilësinë e lëndëve djegëse benzine dhe diesel”, VKM nr. 970, datë 02.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënie e licensave për tregëtimin e naftës bruto dhe nën produkteve të saj”.

III. Argumentim i përlogaritjes së fondit limit:

Referuar ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregëtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, Kreu III, neni 21/7 pika 5, ku citohet: *Të gjitha institucionet shtetërore që zhvillojnë procedura prokurimi për produktet dhe nënproduktet e naftës dhe gazit, të përcaktuara në vendimin e Bordit, duhet të mbajnë në konsideratë parashikimet e këtij ligji, si dhe vendimet e Bordit për çmimet e miratuara të produkteve dhe nënprodukteve të naftës dhe gazit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së periudhës së veçantë., çmimi për njësi, është vendosur në zbatim të Vendimit të Bordit të Transparencës nr. 19 datë 09.05.2026.*

Sasia e nevojshme për periudhën 12 mujore të MK është përlogaritur referuar normativave mujore të konsumit të karburantit për secilin automjet të DPÇK, 8 automjete furgon frigoriferik të cilët punojnë me Gazoil dhe 2 autovetrua të cilat punojnë me benzinë.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.